




Pranuar / Dorezuar Punëdhënësi/Prodator Received/Delivered	27-06-2022	2 viti god year	
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr. Prot Nr. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK	3760/2022		119



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.486/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, bazuar në Aktgjykimin AA.nr.639/2020 të datës 19.04.2022 të Gjykatës së Apelit /Departamenti për Çështje Administrative, ka rishqyrtuar ankesën me numër A02/39/2015 të datës 02.02.2015 të parashtruar nga ankuesja kundër Vendimit me numër 01.007-288464 të datës 23.01.2015 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike “Ndërprerje e marrëdhënies së punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 27.06.2022, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A02/39/2015 e datës 02.02.2015 e parashtruar nga ankuesja
- II. Anulohet Vendimi Nr.01.007-288464 i datës 27.01.2015 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave dhe Vendimi me numër 116-261616 i datës 19.12.2014 i Komisionit Disiplinor, të Komunës së Prishtinës, si dhe Akti i Emërimit i datës 24.07.2014 me numër 01-112-990.
- III. Obligohet Kryetari i Komunës së Prishtinës, për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtë, duke kthyer ankuesen në vendim e punës sipas Akt Emërimit të datës 11.12.2012 me numër 01-112-990 në pozitën “Zyrtare e Lartë për Politika të Planifikimit dhe të Ndërtimit Urban”, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e saj nga marrëdhënia e punës si dhe të bëjë kompensimin e të gjitha pagave të ankueses nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në zbatimin e këtij vendimi.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Ankuesja, e punësuar në pozitën e punës “Zyrtar e Lartë për Politika të Planifikimit dhe të Ndërtimit Urban” në Komunën e Prishtinës, me datë 02.02.2015 ka parashtruar ankesën me numër protokolli 310/2015 të regjistruar me numër A02/39/2015 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër 116-261616 të datës 19.12.2014 të Komisionit Disiplinor, me të cilin vendim i është ndërprerë marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil, dhe Vendimit me numër 01-007-288464 të datës 23.01.2015 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 01.04.2015 me Vendimin me numër A/02/39/2015 ankesën e ankueses e ka hedhur poshtë si të palejuar, ndërsa kjo e fundit e pa kënaqur me Vendimin me numër A/02/39/2015, me datë 22.05.2015 ka hapur konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore, me Aktgjykimin me numër A.nr.689/18 të datës 28.09.2020 ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar dhe ka vërtetuar Vendimin A/02/39/2015 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kundër Aktgjykim A.nr.689/18 të datës 28.09.2020, ankuesja ka parashtruar ankesë me datë 22.10.2020 në Gjykatën e Apelit të Kosovës/Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata e Apelit, me datë 19.04.2022 me Aktgjykimin me numër AA.Nr.639/2020 ka aprovuar ankesën e ankueses si të bazuar dhe rrjedhimisht ka anuluar Aktgjykimin A.nr.689/18 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrativ, dhe Vendimin me numër A/02/39/2015 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe lëndën e ka kthyer në rivendosje dhe ri-shqyrtim.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:* Aktgjykimin AA.nr.639/2020 të Gjykatës së Apelit/Departamenti për Çështje Administrativ; Aktgjykimin A.nr.689/18 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrativ; Ankesën e ankueses te datës 02.02.2015 te parashtruar në Këshillin e Pavarura Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Raportin e datës 19.11.2014 për shkelje disiplinore të supozuar; Vendimin e datës 22.07.2014 për caktimin e ushtrueses të detyrës Udhëheqëse e Shërbimit për kushtet ndërtimore; Vendimin e datës 19.12.2014 të Komisionit Disiplinor; Përgjigjen e ankueses te datës 31.07.2014 për propozim për transferim të shërbyesit civil; E-mailin e datës 18.08.2014, 30.09.2014; 29.10.2014; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor te datës 18.12.2014; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor te datës 19.12.2014; Deklarata e ankueses e datës 18.12.2014 ndaj supozimit të shkeljes disiplinore; e-mail i datës 04.11.2014; Ankesa e ankueses e datës 23.01.2015 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës; Vendimin e datës 01.12.2014 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Vendimin e datës 01.12.2014 te Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Ankesën e ankueses te datës 31.12.2014 te parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës; Vendimin e datës 27.01.2015 te Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës; Propozimin e

datës 22.08.2014 për transferimin e shërbyesës civile; Akt emërimit të ankesës të datës 27.07.2014; Ankesën e ankesës të datës 13.11.2014 të parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës, kundër transferimit; Vendimin e datës 13.11.2014 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës; Fletëthirrjen për Komision Disiplinor; Raportin e ndërprerjes së përkohshme të punës të datës 28.10.2014; E-mailin e datës 30.07.2014, 24.08.2014; 08.09.2014, 30.09.2014, 07.11.2014, 17.11.2014; Shtojcën e datës 22.10.2014; Njoftimin e datës 27.06.2014; Vërtetimin për mos posedim të mjeteve të punës të datës 27.06.2014; Njoftimin e ankesës të datës 02.04.2014 për Kryetarin e Komunës së Prishtinës; Raportin për hyrje dalje nga puna për ankesën nga data 01.01.2014 gjer më 31.12.2014, Përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit, si dhe shkresat tjera të bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë ka konstatuar se ankesa e ankesës *është e bazuar, SEPSE:*

Bazuar në shkresat e lëndës është konstatuar se ankesja sipas Aktit Emërimit me numër 01-112-990 të datës 11.12.2012 ka qenë e punësuar me afat të pacaktuar – përhershme në pozitën e punës “Zyrtare e Lartë për Politika të Planifikimit dhe të Ndërtimit Urban” në Kabinetin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës. Kryetari i Komunës së Prishtinës, me Vendimin 01 nr.119-171960 të datës 22.07.2014, ankesën e ka sistemuar në pozitën e punës Ushtruese e detyrës së Udhëheqësit të Shërbimit për Kushte Ndërtimore, me afat të caktuar, respektivisht për periudhën 01.08.2014 – 31.10.2014 dhe njëkohësisht të njëjtës i është ofruar për nënshkrim Akt Emërimi me numër 01-112-990 i datës 24.07.2014 për vendin përkatës të punës, në të cilën shkruante se: *Emërimet me afat të caktuar nuk krijojnë asnjë detyrim për vazhdimin e marrëdhënies së punës.*

Kolegji i Këshillit pas evidentimit dhe shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe akteve administrative të kontestuara nga ankesja, e të cilat janë kronologjike të ndërlidhura me njëra tjetrën edhe në kuptim të prodhimit të efekteve juridike ndaj palës, ka konstatuar se ankesja ka refuzuar nënshkrimin e aktit të emërimit, dhe rrjedhimisht pozitën përkatëse të punës me pretendimin se i janë cenuar të drejtat nga marrëdhënia e punës, ndërsa Drejtori i Drejtorisë së Urbanizimit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, me datë 19.11.2014 ka kërkuar iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankesës me pretendimin se e njëjta ka kryer shkelje të rënda disiplinore me mos paraqitjen e saj në punë që nga data 01.08.2014. Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës me datë 19.12.2014 ka nxjerr Vendimin me numër 116-261616 me të cilin ankesës i ka shqiptuar masën disiplinore “Ndërprerje e marrëdhënies së punës në shërbimin civil pa dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension”, me arsyetimin se ankesja ka kryer aktivitete që bien ndesh me interesat e institucionit apo veprime që e dëmtojnë institucionin dhe organet shtetërore, shkelje të detyrave të punës që kanë pasoja për palën dhe organin shtetëror, mos ofrimi i ndihmës profesionale në kuadër të kompetencave dhe detyrave të punës nëpunësve civilë, gjatë realizimit të drejtave të tyre dhe mungesa të paarsyeshme për më shumë se dy ditë punë të njëpasnjëshme.

Kundër Vendimit me numër 116-261616 të datës 19.12.2014 të Komisionit Disiplinor, ankesja më datë 23.01.2015 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 01-007-18905 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës. Ky i fundit më datë 27.01.2015 me

Vendimin me numër 01-007-288464 ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses të datës 23.01.2015 dhe ka lenë në fuqi Vendimin me numër 116-261616 të datës 19.12.2014 të Komisionit Disiplinor, me të cilin ankueses i është shqiptuar masa disiplinore *"Ndërprerje e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil"*.

Ankuesja, me ankesën e parashtruar me date 02.02.2015 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka kontestuar Vendimin me numër 116-261616 të datës 19.12.2014 të Komisionit Disiplinor, Vendimin me numër 01-007-288464 të datës 23.01.2015 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës, si dhe aktet dhe veprimet që i kanë parapri këtyre vendimeve, siç është Vendimi 01 nr.119-171960 i datës 22.07.2014 për sistemimin e ankueses në pozitë me afat të caktuar, me pretendimin ankimor se të gjitha këto vendime janë nxjerr në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Kolegji i Këshillit, lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses, fillimisht ka analizuar legjislacionin e aplikueshëm në kohë, sa i përket mënyrës, parakushteve dhe procedurës së caktimit të ushtruesit të detyrës, dhe duke ju referuar dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, përkatësisht nenin 30 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *"Nëpunësit civilë, me urdhër nga eprori, janë të detyruar që përkohësisht ta zëvendësojnë një koleg i cili mungon ose ta plotësojnë një vend të lirë të punës, nëse veprimtaria e zakonslume e institucionit do të pengohet nga mungesa e nëpunësit civil"* si dhe nenin 31 paragrafin 1 të të njëjtit ligj ku përcaktohet se: *"Nëpunësit civilë mund të refuzojnë kryerjen e funksioneve dhe detyrave, përveç atyre të përcaktuara në përshkrimin e detyrave të punës, nëse kryerja e këtyre funksioneve apo detyrave: 1.1. do të ishte në dëm të interesave dhe të drejtave të tyre të ligjshme; 1.2. do të rrezikonte shëndetin e tyre; 1.3. do të kërkonte një kualifikim më të lartë ose trajtim të ndryshëm profesional nga ai i dhënë"*, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankueses lidhur me sistemimin e përkohshëm është i bazuar sepse nga shkresat e lëndës rezulton se ankueses përveç Vendimit të datës 22.07.2014 me të cilin është sistemuar ushtruese e detyrës së Udhëheqësit të Shërbimit për Kushte Ndërtimore, të njëjtës, në të njëjtën kohë organi i punësimit i ka lëshuar edhe Aktin e Emërimit për pozitën përkatëse të punës, me afat të caktuar, duke ia cenuar të drejtat e ligjshme të ankueses që burojnë nga themelimi i marrëdhënies së përhershme të punës sipas Akt Emërimit me numër 01-112-990 të datës 11.12.2012.

Me rastin e ndryshimit të aktit të emërimit, duke u thirrur në dispozitat ligjore të nenit 96 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: *"Brenda një (1) viti, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të gjitha kontratat e punës në Shërbimin Civil të Kosovës, për pozitat të cilat për nga natyra, funksioni dhe detyrat janë pozita të përhershme, zëvendësohen me shkresa të emërimit, siç është përcaktuar me këtë ligj dhe me aktet e reja nënligjore"* si dhe nenit 15 të Rregullores Nr.07/2010 për Emërimin e Nëpunësve Civilë, ku përcaktohet se: *"Në përputhje me këtë Rregullore, të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës obligohen të sigurojnë zëvendësimin e kontratave të punës në Shërbimin Civil, për pozitat të cilat për nga natyra, funksioni dhe detyrat janë pozita të përhershme me akte të emërimit, në pajtim me nenin 97 të Ligjit për Shërbimin Civil"*, organi i punësimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: *"Nëpunësit civilë kanë të drejtë në trajtim të barabartë në të gjitha aspektet e menaxhimit të personelit, duke përfshirë karrierën, shpërblimet, kompensimin dhe mbrojtjen ligjore, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi fetar, politik, aftësitë e kufizuara, kushtet, statusi martesor, mosha ose prejardhja etnike"* si dhe nenin 45 paragrafin 1 të të njëjtit ligj ku përcaktohet se: *"Nëpunësve civilë u garantohet mbrojtja*

*kundër çfarëdo largimi të paarsyeshëm ose të panevojshëm nga vendi i tyre i punës ose ndryshimi i qëndrimit në detyrë”, pasi që dispozitat ligjore mbi bazën e të cilit ankueses i është ndërruar akt i emërimit nga ai me afat të pacaktuar-karrierës, në akt emërim të ri me afat të caktuar prej tre (3) muajsh, janë dispozita kalimtare respektivisht të njëjtat kanë shërbyer vetëm për periudhën 1 vjeçare nga hyrja zyrtare në fuqi e Ligjit për Shërbimin Civil me datë 11.07.2010, përmes të cilave dispozita është përcaktuar që të punësuarve në shërbimin civil, kontratat e punës tu shndërrohen në akte të emërimit.*

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit konstaton se në rrethanat e rastit konkret, veprimet e ndërmarra nga ankuesja për refuzimin e zbatimit të urdhrit nga eprori, respektivisht zbatimin e Vendimit të datës 22.07.2014 me të cilin e njëjta ishte sistemuar si ushtruese e detyrës se Udhëheqësit të Shërbimit për Kushte Ndërtimore, vendim ky që ishte përcjell edhe me ndryshimin e Aktit të Emërimit me numër 01-112-990 të datës 24.07.2014, janë veprime të drejta dhe të ligjshme të cilat veprime për burim e kanë nenin 31 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: *“Nëpunësit civilë mund të refuzojnë kryerjen e funksioneve dhe detyrave, përveç atyre të përcaktuara në përshkrimin e detyrave të punës, nëse kryerja e këtyre funksioneve apo detyrave: 1.1. do të ishte në dëm të interesave dhe të drejtave të tyre të ligjshme”,* pasi që ndryshimi i Aktit të Emërimit me numër 01-112-990 të datës 11.12.2012 i ka cenuar të drejtat e ligjshme të ankueses që burojnë nga themelimi i marrëdhënies së përhershme të punës, të njohura edhe me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil. Po ashtu, insistimi i Kryetarit të Komunës së Prishtinës, si dhe Drejtorit të Drejtorisë së Urbanizimit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, që ankuesja të pranojë detyrën e re me afat të caktuar janë veprim që bien ndesh me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, përkatësisht nenin 43 paragrafi 3 ku përcaktohet se: *“Nëpunësit civilë do të trajtohen nga eprorët e tyre me respekt ndaj dinjitetit të tyre njerëzor dhe nuk do t’u kërkohet që të kryejnë detyra të cilat mund ta dëmtojnë atë”*.

Kolegji i Këshillit, nga administrimi i provave ka gjetur se Vendimi i datës 22.07.2014 i organit të punësimit, përmes të cilit ankuesja është sistemuar si ushtruese e detyrës se Udhëheqësit të Shërbimit për Kushte Ndërtimore, dhe i cili është përcjell edhe me ndryshimin e aktit të emërimit, nuk përmban njërin nga elementet kryesore të aktit administrativ, siç është arsyetimi, të përcaktuar me nenin 85 pika 1 nën pika (a) të Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative, dhe si rrjedhojë mungesa e arsyetimit i ka pamundësuar palës ankuese që të kuptoj aktin administrativ dhe si i tillë ka krijuar pasiguri juridike. Andaj, Kolegji i Këshillit konstaton se Vendimi i datës 22.07.2014 dhe Akti i Emërimit i datës 24.07.2014 me numër 01-112-990 janë akte absolutisht të pavlefshme në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative, përkatësisht nenit 92 pika c dhe d, ku përcaktohet se: *92. Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme: c) kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën e kërkuar nga ky ligj ose ndonjë ligj tjetër, d) kur akti është nxjerrë në kundërshtim me procedurën e parashikuar nga ky Ligj ose ndonjë ligj tjetër”,* dhe si të tilla nuk prodhojnë asnjë efekt juridik ndaj palës ankuese sikurse parashihet me nenin 93 pika 1 dhe 2 të njëjtit ligj, ku përcaktohet se: *93.1 Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk prodhon asnjë pasojë juridike. 93.2 Të gjitha organet e administratës publike ose personat fizikë dhe juridikë të cilëve iu drejtohet akti administrativ absolutisht i pavlefshëm duhet të injorojnë urdhërimin e tij për të vepruar”,* pasi që të dy aktet në rastin konkret janë nxjerrë në kundërshtim me procedurën dhe elementet e përcaktuar nga ky ligj dhe ligji material, dhe si të tilla

kanë cenuar të drejtat e ankueses për ruajtjen e përhershme të vendit të punës nën kushtet e ligjit që burojnë nga akti i themelimit të marrëdhënies së punës.

Andaj, bazuar si me sipër, dhe duke marr parasysh se masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankueses ndërlihet me sistemimin e saj në pozitën përkatëse të punës, gjegjësisht mosparaqitjen e saj në punë gjatë periudhës së sistemimit, Kolegji i Këshillit vlerëson se Komisioni Disiplinor me rastin e konstatimit të përgjegjësisë dhe njeherit shqiptimit të masës disiplinore nuk ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, dhe po ashtu nuk ka zbatuar drejtë ligjin material, sepse asnjë nga rrethanat e cekura më lart nuk i ka marr parasysh e të cilat Kolegji i Këshillit vlerëson se janë vendimtare në marrjen e vendimit përfundimtar.

Kolegji i Këshillit, ka gjetur se Kryetari i Komunës së Prishtinës përmes e-mailit të datës 18.08.2014, drejtuar ankueses, ka theksuar se "*... unë nuk kam nevojë për këshilltar për planifikim urban...*" ndërsa në pozitën të cilën është sistemuar ankuesja, për kohë të caktuar, i është ofruar për nënshkrim Akti i Emërimit me numër 01-112-990 i datës 24.07.2014 në të cilin shkruan se: *Emërimet me afat të caktuar nuk krijojnë asnjë detyrim për vazhdimin e marrëdhënies së punës*, nga kjo mund të shihet se qëllimi i transferimit ka qenë largimi i ankueses nga pozita e saj e përhershme, ndërsa akt emërimi që i është ofruar për nënshkrim, për shkak të përmbajtjes ka krijuar pasiguri reale të ankuesja nëse të njëjtës do t'i vazhdohet marrëdhënia e punës pas kalimit të kohës së caktuar, gjegjësisht pas datës 31.10.2014. Andaj, Kolegji i Këshillit vlerëson se Komisioni Disiplinor nuk ka konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike duke neglizhuar faktin se ankuesja sipas Aktit të Emërimit me numër 01-112-990 të datës 11.12.2012 ka qenë e punësuar me afat të pacaktuar – përhershme në pozitën e punës "*Zyrtare e Lartë për Politika të Planifikimit dhe të Ndërtimit Urban*" dhe se sistemimi në pozitën e punës Ushtruese e detyrës së Udhëheqësit të Shërbimit për Kushte Ndërtimore, me afat të caktuar, ka cenuar të drejtat nga marrëdhënia e sa e punës si nëpunëse civile e karrierës.

Kolegji i Këshillit po ashtu në shkresë të lëndës ka gjetur se ankuesja me datë 30.09.2014 përmes e-mailit drejtuar organit të punësimit ka njoftuar se për shkaqe të problemeve shëndetësore gjendet në pushim mjekësor, nga data 26.09.2014, ndërsa me e-mailin e datës datës 29.10.2014 kishte njoftuar se shenjat mjekësore janë dorëzuar në Zyrën e Personelit. Bazuar në këtë konstatim, Kolegji i Këshillit vlerëson se Komisioni Disiplinor me rastin e konstatimit të përgjegjësisë disiplinore në lidhje me mungesat në punë të ankueses nuk ka vërtetuar në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe si rrjedhojë gabimisht ka zbatuar ligjin material sepse me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, përkatësisht nenit 40 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 përcaktohet se: 1. *Nëpunësit civilë kanë të drejtë në: 1.1. pushim mjekësor*", ndërsa me dispozitat e Rregullores Nr.06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë, përkatësisht nenit 9 paragrafi 1 përcaktohet se: *1.Nëpunësi civil ka të drejtë në pushim mjekësor me pagesë në kohëzgjatje deri në njëzet (20) ditë pune brenda një (1) viti, me kompensim 100% të pagës. Ai duhet të sigurojë për udhëheqësin e tij të drejtpërdrejtë një vërtetim nga organi kompetent mjekësor*", ndërsa neni 10 paragrafi 1 i të njëjtit akt përcakton se: *1. Pas skadimit të pushimit mjekësor me pagesë, nëpunësit civil mund t'i vazhdohet pushimi mjekësor pa pagesë*, nga rrjedh se ankuesja është mbështetur ligjshëm në të drejtën e saj të shfrytëzimit të pushimit mjekësor sikurse është dëshmuar edhe me shenjat e mjekut. Ndërsa, pavarësisht kësaj, nga shkresat e lëndës nuk rezulton se ankuesja ka pranuar ndonjë shkresë nga organi i punësimit se nga data 01.11.2014 mund të kthehet në vendin e saj të punës "*Zyrtare e Lartë për Politika të*

*Planifikimit dhe të Ndërtimit Urban*" sipas Aktit të Emërimit numër 01-112-990 të datës 11.12.2012, andaj mbi këtë bazë të mos përputhjes së arsytimit të nxjerrjes së këtij vendimi sikurse edhe të drejtës së mohuar për shfrytëzimin e pushimit mjekësor Kolegji i Këshillit konstaton se ky vendim në kuptim të nenit 92 pika c dhe d, të Ligjit Nr.02/1-28 për Procedurën Administrative ku përcaktohet se: "Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme: c) kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën e kërkuar nga ky ligj ose ndonjë ligj tjetër, d) kur akti është nxjerrë në kundërshtim me procedurën e parashikuar nga ky Ligj ose ndonjë ligj tjetër", është akt absolutisht i pavlefshëm.

Andaj, Kolegji i Këshillit thekson faktin se ashtu sikurse është pasqyruar edhe më lartë nga të gjeturat dhe shkeljet e evidentuara procedurale e materiale, në rastin konkret Drejtori i Drejtorisë se Urbanizimit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit me rastin e inicimit të procedurës disiplinore ndaj ankueses ka vepruar në kundërshtim me nenin 31 paragrafin 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, respektivisht ka rënë ndesh edhe me nenin 43 paragrafi 3 i të njëjtit ligj, pasi që me Vendimin e datës 22.07.2014 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, si dhe Aktin e Emërimit me numër 01-112-990 të datës 24.07.2014 tani me është konstatuar se i janë cenuar interesat dhe të drejtat e ligjshme të ankueses që burojnë nga marrëdhënia e punës respektivisht e drejta për qëndrim në detyrë, ngase akti i emërimit i karrierës-pa afat i është ndryshuar në akt emërim me afat prej tre (3) muajsh, ndërsa arsytimi i dhënë i Komisionit Disiplinor ku ankuesen e nxjerrë përgjegjëse për shkeljen e kryer duke i shqiptuar masën më të rëndë disiplinore në shërbimin civil është arsyetim kontradiktor ngase një nëpunës civil që mungon në punë nuk mundet në të njëjtën kohe të kryej edhe veprime apo aktivitete tjera zyrtare që dëmtojnë institucionin dhe organet shtetërore, ose të paktën Komisioni Disiplinor është dashur të arsyetoj me fakte dhe prova të qëndrueshme nëse eventualisht ankuesja jashtë ambienteve zyrtare të institucionit gjatë kohës sa ka munguar në punë të ketë kryer veprime që dëmtojnë institucionin, por një arsyetim i tillë mungon. Komisioni Disiplinor po ashtu nuk ka arritur të vërtetoj drejtë gjendjen faktike pasi që refuzim i ankueses për të kryer detyrat dhe funksion sipas aktit të ri të emërimit ka qenë i drejte dhe i ligjshëm sipas nenit 31 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, pasi që ankueses i është cenuar e drejta e qëndrimit në detyra sipas aktit të emërimit e gjetur kjo e pasqyruar edhe më lartë në këtë vendim. Po ashtu, me rastin e shqiptimit të masës disiplinore Komisioni Disiplinor nuk ka arritur të konstatoj drejtë gjendjen faktike, pasi që ankuesja nga data 30.9.2014 deri me datë 28.10.2014 sipas shenjave të mjekut ka qenë në pushim mjekësor duke e shfrytëzuar të drejtën e saj që burojnë nga nenin 40 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe neni 9 paragrafi 1 i Rregullores Nr.06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë.

Andaj, duke u bazuar në të gjitha provat e lëndës dhe të gjeturave të pasqyruara në këtë vendim, Kolegji i Këshillit ka konstatuar që masa disiplinore "ndërprerje e marrëdhënies së punës në shërbimin civil pa dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension" shqiptuar ndaj ankueses është në kundërshtim me nenin 71 paragrafin 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: "Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. të dëgjojë provat lidhur me shkeljen e supozuar; 1.2. të vendosë, në bazë të provave, nëse është kryer shkelja; dhe 1.3. përcakton dënimin që duhet shqiptuar" dhe Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, rrjedhimisht Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 116-

261616 të datës 19.12.2014 nuk ka arritur t'i ushtrojë drejtë kompetencat e veta sipas mandatit ligjor pasi që nuk ka vendosur në bazë të provave të cilat sipas deklarimeve dhe shkresave të evidentuara në procesverbalet e seancave disiplinor janë evidente lidhur me shkeljet e supozuara, ndërsa masën e shqiptuar disiplinore e ka shqiptuar në kundërshtim edhe me nenin 63 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: *"Nëpunësit civilë do t'u nënshtrohen masave disiplinore për shkelje të detyrës, që ka ndodhur si rezultat i fajit të tyre, sikur që është përcaktuar me këtë ligj"* si dhe nenit 64 paragrafi 1 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: *"Nëpunësit civilë janë përgjegjës për çfarëdo shkelje të parimeve të përcaktuara sipas këtij ligji"*, pasi që në bazë të provave të lëndës është provuar e kundërta e saj që ka konstatuar Komisioni Disiplinor, respektivisht ankuesja me veprim apo mos veprimin e saj në rastin konkret nuk e ka shkelur asnjërin nga parimet e përcaktuar me dispozitat e ligjit material përderisa e njëjta ka vepruar në mbrojtje të interesave dhe të drejtave të saj të ligjshme.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Prishtinës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 01-007-288464 i datës 27.01.2015 kur ka refuzuar ankesat e ankueses Luljeta Sokoli, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 02/1-28 për Procedurën Administrative dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, përderisa është e dukshme dhe e provueshme se ankueses i janë shkelur të drejtat e ligjshme që burojnë nga marrëdhënia e punës.

Andaj, pas analizimit të shkresave të lëndës si dhe të gjeturave të pasqyruara si në arsyetimin e këtij vendimi, dhe me qëllim të kthimit të ligjshmërisë, në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 55 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *"Një akt administrativ i paligjshëm për arsye të tjera nga ato ta parapara nga neni 54 i këtij Ligji, mund të anulohet apo të shfuqizohet, me qëllimin për të vendosur ligjshmërinë"* Kolegji i Këshillit vendosi që të anulohet Vendimi Nr.01.007-288464 i datës 27.01.2015 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës, Vendimi me numër 116-261616 i datës 19.12.2014 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës, si dhe Akti i Emërimit me numër 01-112-990 i datës 24.07.2014, ndërsa Kryetari i Komunës së Prishtinës është i obliguar që ankuesen ta kthejnë në vendim e punës sipas Akt Emërimit të datës 11.12.2012 në pozitën *"Zyrtare e Lartë për Politika të Planifikimit dhe të Ndërtimit Urban"* me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e saj që burojnë nga marrëdhënia e punës, duke ia kompensuar të gjitha pagat nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në zbatimin e këtij vendimi si dhe të shuaj masën disiplinore ndaj ankueses nga dosja personale e saj, në pajtim me këtë vendim dhe dispozitat ligjore në fuqi.

Në rast se pozita e punës e përcaktuar në Aktin e Emërimit të datës 11.12.2012 nuk është e lirë, apo është shuar si rezultat i riorganizimit, ankuesja mund të sistemohet në një pozitë të ngjashme/barasvlershme për nga detyrat dhe përgjegjësitë, në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.



Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamentin për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.486/2022

Valentina Kaçandolli - Bekteshi  
  
Procesmbajtëse



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuese;
- Kryetari i Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.